



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha Raportuese	Korrik 2018
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në vazhden e punëve dhe detyrave të planifikuara për muajin korrik të vitit 2018, ka arritur me sukses dhe rezultate të kënaqshme t'i finalizojë të gjitha punët në kohë optimale.

Pra, realizimi i punëve dhe detyrave të planifikuara ka reflektuar në shumë dimensione progresive për proceset arsimore.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Mbikëqyrja e vazhdueshme e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Transferimi (migracioni) i brendshëm i personelit dhe i mësimdhënësve nga një shkollë në një shkollë tjetër dhe nga një vend pune në një tjetër, në bazë të nevojave dhe mundësive;
- Sistemimi i mësimdhënësve nga një shkollë në shkollën tjetër, si rezultat i ndryshimeve kurrikulare;

- Krijimi i ekipeve në nivel të institucioneve edukative e arsimore për përgatitjen dhe koordinimin e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës;
- Formimi i Asociacionit të drejtorëve të shkollave, që funksionon si trup në sigurim të cilësisë;
- Sigurimi i koordinatorit të cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar, sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Hartimi dhe zbatimi i planit për konsolidimin e shkollave;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit parauniversitar (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësisimit Profesional);
- Zbatim i monitorimit të zbatimit të kurrikulës;
- Hartimi i kurrikulave të AAP-së;
- Krijim i mekanizmave për nxitjen e përkrahjes dhe motivimit të mësimdhënësve për zbatim të kurrikulës;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Tenderimi i kompanisë për furnizim;
- P.sh. School Me, ose platforma online të të nxënësve (2018 – pilotim);
- Tenderimi i kompanive dhe pajisja e shkollave me punëtori, laboratorë/kabinete dhe materiale shpenzuese;
- Identifikimi i nevojave të mësimdhënësve për trajnime;

- Trajnimi i mësimeve;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi, që janë të interesuar të kontribuojnë në shkollë;
- Krijimi i mekanizmave brenda shkollave të cilat do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këta donatorë;
- Zbatimi i masave të programit për ndërtim, zgjerim, renovim dhe përmirësim të infrastrukturës së IP-ve;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Hartimi i rregullores që organizon (mbledhjen) ngritjen e kontributeve dhe donacioneve nga prindërit dhe komuniteti;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Vlerësimi i nevojave dhe kërkesave për zhvillim profesional të edukatoreve dhe personelit administrativ;
- Aftësohet personeli për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB-së në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA-së për numër të fëmijëve në IP;
- Krijimi i një ekipi komunal (zyrtarë të arsimit, zyrtarë të inspeksionit sanitar, infrastrukturë, profesionistë të fushës etj.) për organizimin e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollit të zbatimit të standardeve të EPSH (këshillohet që ky ekip të mos merret vetëm si inspektim, por edhe si këshillues e përkrahës - në të përfshihen edhe profesionistë - ekspertë; nuk është mirë të duplikohet inspektimi);
- Ekipi komunal harton planin e përmirësimit për tejkalimin e problemeve dhe avancimin e standardeve të IP-ve në komunë;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH-së;
- Trajnimi i mësimeve për shmangie të ndëshkimit fizik ndaj nxënësve;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimeve që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Takime të rregullta individuale me prindër;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrah NNV-në dhe nxënësit me talente;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;

- Sigurimi i të dhënave për planifikimin e buxhetit;
- Përgatitja e tenderëve për mallra dhe shërbime;
- Përgatitja e lëndëve për mallra dhe shërbime;
- Përcjella dhe realizimi projekteve nga donatorët;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Aprovimi i pagesave;
- Barazimi i pagesave me freebalance;
- DDD-ja e institucioneve arsimore;
- Furnizimi me dru i institucioneve arsimore;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me material didaktik dhe higjienike;

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët sipas planit dinamik, janë duke operuar në terren dhe duke e përcjellë nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale;
- Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, speciale, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Pra, në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Prishtinës, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë muajit korrik të vitit 2018, kanë realizuar planin e punës. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar 2 vizita të përgjithshme në SHFMU "Dardania" dhe në SHML "Gjin Gazulli", ndërsa një vizitë speciale në shkollën fillore "Shkolla e Gjelbër";
- Drejtoria e Arsimit, në funksion të zhvillimeve dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, ka zgjedhur koordinatoren e cilësisë në nivel komune dhe njëkohësisht

ka arritur t'i zgjedhë mbi 20 koordinatorë të shkollave dhe në vijimësi është duke bërë përpjekje që në secilën shkollë të emërohet koordinatori i cilësisë, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuar sipas Udhëzimit administrativ 24/2016. Po ashtu, gjatë muajit qershor koordinatorët e cilësisë të secilit institucion kanë raportuar mbi punët dhe detyrat e realizuar gjatë vitit shkollor 2017/18;

- Gjatë muajit korrik është realizuar një analizë dhe vlerësim i përgjithshëm mbi raportet e koordinatorëve të cilësisë për punët dhe detyrat e realizuara, ku në disa raste është vërejtur se nuk kanë treguar kompetencë dhe profesionalizëm për ushtrimin e detyrës së koordinatorit të cilësisë, duke mos arritur t'i realizojnë punët dhe detyrat siç është e përcaktuara me Udhëzimin administrativ, nr. 24/2016, për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar.

Pra, është indikativ fakti se politikat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për funksionalizimin e koordinatorëve të cilësisë për secilin institucion të nivelit të arsimit parauniversitar, konsiderohet i dobishëm dhe progresiv për zhvillimin e proceseve arsimore, por, fatkeqësisht, ky proces nuk është studiuar në detaje nga MASHT, duke përcaktuar që këtë pozitë të ushtrojnë mësimdhënësit të cilët janë në proces mësimor.

Nga vlerësimi i të dhënave të prezantuar nga koordinatorët, konstatohet se kjo mënyrë e konceptuar për funksionalizimin e koordinatorëve të cilësisë sipas UA-së, nuk ka reflektuar pozitivisht, duke mos përmbushur kërkesat sipas standardeve të përcaktuara për realizimin e kësaj detyre me profesionalizëm. Andaj, nga analiza e realizuar mbi punët dhe detyrat e koordinatorit të cilësisë, konsiderohet sfiduese çështja e përcaktimit të koordinatorit të cilësisë, sepse mësimdhënësit nuk kanë treguar kompetencë dhe profesionalizëm të duhur për realizimin e kësaj detyre.

Në mënyrë që të ndërtojmë një sistem të mirë të arsimit, ku do të kemi zhvillim, përparim, avancim dhe ngritje të cilësisë në arsim, duhet të mundësohet punësim i pedagogëve, të cilët do ta luajnë rolin e koordinatorit të cilësisë dhe jo siç është caktuar sipas Udhëzimit administrativ, nr.24/2016.

Pra, në të mirë të ecurive dhe zhvillimeve progresive në sistemin e arsimit parauniversitar, në pozitën e koordinatorit të cilësisë duhet të caktohet pedagog i përgjithshëm, i cili është kompetent për ushtrimin e këtij funksioni. Mandej, secili institucion arsimor që ka mbi 500 nxënës, duhet t'i sigurohet koordinatori i cilësisë (pedagog i përgjithshëm), ndërsa shkollat që kanë numër të nxënësve me pak se 500 nxënës, të caktohet një koordinator i cilësisë (pedagog i përgjithshëm) të ushtrojë detyrën në dy e më shumë shkolla. Pozita e koordinatorit të cilësisë duhet të analizohet mirë nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal, dhe të ndahet linjë buxhetore për punësimin e pedagogëve

të përgjithshëm për pozitën e koordinatorëve të cilësisë, sepse punësimi i tyre do të reflektojë në shumë dimensione në të mirë të zhvillimeve dhe avancimeve të proceseve arsimore;

- Aktivitet profesional (seksionet), në funksion të zhvillimeve të proceseve progresive në sistemin e arsimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim, gjatë kësaj periudhe kanë realizuar punët dhe detyrat e përcaktuara, dhe në fund të muajit kanë përgatitur raporte mbi ecuritë dhe zhvillimet e përgjithshëm në shkollë. Po ashtu, edhe aktivitetet profesionale në vazhdimësi janë duke u mbikëqyrë dhe mentoruar nga drejtuesit e shkollave përkatëse për punën e tyre, ndërsa Drejtoria e Arsimit në vazhdimësi i ka mbështetur me këshilla profesionale aktivitetet profesionale dhe i ka informuar për rëndësinë e madhe që kanë në zhvillimin e arsimit, njëherësh u ka përgatitur formën raportuese për punët dhe detyrat e realizuara për çdo muaj;
- Në dymbëdhjetë institucione edukativo-arsimore, janë formuar ekipe për vlerësimin e brendshëm të shkollës. Për punët dhe detyrat e realizuar gjatë vitit shkollor 2017/18, ekipet kanë raportuar në Drejtorinë e Arsimit dhe kanë realizuar vlerësimin e brendshëm të shkollës për pesë fushat e cilësisë, si: menaxhimi dhe qeverisja, kultura dhe mjedisi shkollor, mësimdhënia dhe nxënia, zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe performanca e nxënësve;
- Mësimi jo formal në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, është duke u realizuar sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë;
- Organizimi dhe zhvillimi i mësimin joformal është duke u mbajtur në pesë institucione të nivelit të arsimit të mesëm të lartë dhe në një institucion të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët. Ky proces në këto institucione është duke u zhvilluar sipas dinamikës dhe planifikimit të paraparë;
- Është realizuar analizë e përgjithshme mbi gjendjen e institucioneve edukativo-arsimore dhe është realizuar sistemimi i mësimdhënësve që kanë mbetur pa orë, ose me më pak orë mësimore, si rezultat i zhvillimeve në sistemin e arsimit dhe zvogëlimit të nxënësve në shkollat në zonat rurale;
- Hapja e konkursit për pranimin e stafit të ri arsimor;
- Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ekipi profesional ka operuar sipas planifikimeve të parapara për adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Në këtë periudhë kohore nuk kanë realizuar ndonjë vlerësim të fëmijëve;
- Realizimin e praktikës profesionale me nxënësit e shkollave profesionale, gjatë muajit qershor është realizuar në një masë, por jo në nivel të kënaqshëm. Kjo është si pasojë e disa faktorëve, si: mos gatishmëria e bizneseve për pranin të nxënësve, mungesa e transportit etj. Pra është indikativ fakti se

praktika profesionale për nxënësit e shkollave profesionale, është determinuese në zhvillimin dhe përgatitjen e tyre profesionale.

Faza e katër e trajnimit për KKK

Institucionet e nivelit lokal dhe atij qendror, për të siguruar se proces i filluar për përgatitjen e mësimdhënësve për zbatueshmërinë në praktikë të KKK-së në institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar, kanë ndërmarrë veprime konkrete, ku gjatë periudhës 6-16 korrik, është organizuar faza e katërt e trajnimit. Pjesëmarrës në këtë fazë ishin 197 mësimdhënësit në këto fusha të kurrikulës: edukatë fizike, sporti dhe shëndeti, programit parafillor-fillor, jeta dhe puna dhe në fushën e arteve. Gjithsej në këtë fazë janë trajnuar 197 mësimdhënës, të ndarë sipas fushave kurrikulare:



Nr.	Fusha e kurrikulës	Numri i grupeve	Numri i vijuesve
1	Artet	2	77
2	Edukatë fizike, sporti dhe shëndeti	2	46
3	Niveli i arsimit fillor	1	40
4	Niveli i arsimit përgatitor	1	34
	Gjithsej	6	197

Në këtë fazë të trajnimit në komunën e Prishtinës, ishin të përfshirë edhe mësimdhënës nga të gjitha komunat e Kosovës. Po ashtu, në ditën e fundit të secilës fazë të trajnimit, janë përcjellë formularët e vlerësimit të trajnimit për secilin mësimdhënës, për të parë këndvështrimin e tyre rreth këtyre zhvillimeve reformuese që janë duke



u zhvilluar në sistemin e arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës. Andaj, pas analizës dhe vlerësimit të përgjithshëm të formularëve të plotësuar nga mësimdhënësit, konstatohet se shumica e mësimdhënësve pjesëmarrës deklarohen se janë të kënaqur me trajnimin e mbajtur dhe kanë arritur të fitojnë njohuri të mira për KKK, por konsiderojnë se janë të ngarkuar shumë me administratë. Po ashtu, kërkesë e mësimdhënësve është, që të organizohen trajnime të ndryshme, të cilat do të ndihmonin shumë në implementimin e Kurrikulës. Shumica e mësimdhënësit janë të kënaqur me punën e realizuar nga trajnerët e fushave të ndryshme, duke i konsideruar si kompetentë dhe profesionalë për KK;

- Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, duke i parë zhvillimet e hovshme bashkëkohore në fushën e arsimit dhe nevojat për krijimin e kushteve sipas standardeve bashkëkohore për arsimim cilësor, ka ndërmarrë hapa konkret në këtë drejtim, duke intervenuar dhe zgjeruar hapësirat shkollore. Andaj, në funksion të këtyre zhvillimeve të proceseve arsimore, në lagjen "Arbëria" është ndërtuar objekt i ri shkollor sipas standardeve më të larta të kohës, duke krijuar mundësi dhe kushte optimale për mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore.



Pra, objekti i ri shkollor është realizuar sipas standardeve bashkëkohore dhe me strukturë arkitektonike funksionale, që do të bëjë të mundshëm qëndrimin e këndshëm dhe të rehatshëm të nxënësve dhe personelit arsimor, ambient të shëndoshë, ku do të zhvillohet mësimi teorik dhe praktik (në klasë kabinetike...), ku do të zhvillohen aktivitete kulturore-zbavitëse, rekreative-sportive etj.



Objekti i ri shkollor është i projektuar dhe dizajnuar në këtë formë, ku ka gjithsej 13 dhoma mësimi dhe katër dhoma për kabinete. Aty janë 2 dhoma mësimi për nivelin e arsimit parafillor, 11 dhoma mësimi për nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët dhe 4 dhoma për kabinete. Andaj, Drejtoria e Arsimit pas analizës dhe vlerësimit të përgjithshëm mbi demografinë e popullsisë në lagjet apo zoonimin ku shtrihen shkollat



fillore, si: SHFMU "Meto Bajraktari", SHFMU "Qamil Batalli" dhe SHFMU "Faik Konica", konstaton se numri i nxënësve në këto shkolla është i madh nëpër paralele, andaj propozon që një numër i konsiderueshëm i këtyre nxënësve nga viti i ri shkollor 2018/19, të dërgohen në shkollën e re në lagjen "Arbëria", por shumica e nxënësve të shkollës fillore "Meto Bajraktari", do të transferohen në këtë institucion arsimor, mbase kjo shkollë është shumë e ngarkuar me nxënës dhe shkolla e re ku është ndërtuar është kryesisht zonë që mbulon shkolla "Meto Bajraktari".

I gjithë ky proces do të realizohet në koordinim të plotë me drejtuesit e tri shkollave të potencuara dhe organet e brendshme të shkollës.

Gjithashtu, pas analizës dhe vlerësimit të përgjithshëm mbi kapacitetet hapësinore të objektit të ri shkollor, konstatohet se procesi edukativo-arsimor në këtë institucion mundet të organizohet-zhvillohet në një ndërresë vetëm me nga një paralele nga klasa I - IX, ose në dy ndërresa me nga dy paralele nga klasa I - IX.

Në funksion të funksionalizimit të institucionit arsimor në lagjen "Arbëria" nga një shtatori i vitit 2018, më 5 korrik 2018, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit, të Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimi Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, drejtuesit e shkollave "Meto Bajraktari", "Qamil Batalli" dhe "Faik Konica", kanë realizuar zoonimin e shkollave në mënyrë preliminare, në mënyrë që shkollave në fillim t'u ndihmojë në ndarjen e nxënësve. Këto zhvillime më së shumti do të reflektojnë dhe ndikojnë pozitivisht në shkarkimin e shkollës fillore "Meto Bajraktari";

- Drejtoria e Arsimit, me kohë të duhur ka përcjellë Udhëzimin administrativ 08/2016, për vlerësimin e nxënësve sipas kornizës së kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht modelin sipas

standardeve të kërkuara për vlerësim. Po ashtu, janë përcjellë edhe informata të tjera të domosdoshme në të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar dhe janë dhënë këshilla të nevojshme për këtë proces, por duhet theksuar se vlerësimi akoma mbetet sfidë dhe ka nevojë për mbështetje permanente;

- Në rast se ka tendencë për çfarëdo dhunë apo shkelje të të drejtave të fëmijëve-nxënësve në institucionet arsimore, Drejtoria merr masa të menjëhershme komfor legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe Rregullores komunale për arsim;
- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Shpallja e rezultateve për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore, për vitin kalendarik 2018/19;
- Vizita në shkolla, sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;
- Analizë dhe vlerësim i përgjithshëm mbi suksesin e nxënësve të arritur në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, gjatë gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2017/2018;
- Vlerësim i përgjithshëm mbi suksesin lëndor të arritur në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2017/2018;
- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave për mësimdhënësit të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për ri-licencim dhe për mësimdhënësit që i plotësojnë kushtet dhe kriteret për avancim në karrierë, për të tri nivelet e arsimit parauniversitar;
- Plotësimi me të dhëna lidhur me veprimet që dalin nga agjenda evropiane, më konkretisht nga Plani kombëtarë për zbatimin e MSA-së (PKZMSA), për periudhën janar – qershor 2018;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit korrik;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore. Në procesin e hapjes dhe vlerësim të tenderëve marrin pjesë gjithnjë nga tre përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Në kohë të paraparë janë furnizuar të gjitha institucione edukativo-arsimore me lëndë djegëse dru;
- Janë furnizuar në vazhdimësi të gjitha institucionet me materiale didaktike, higjienike dhe mallra dhe shërbime tjera;
- Është realizuar projekti “Furnizimi i bibliotekave shkollore me libra”;
- Planifikimi i buxhetit të vitit ‘18, për buxhet BDMS;
- Ndarja e buxhetit sipas programeve dhe nënprogrameve;

- Janë nënlokuar pagat për 64 institucione shkollore;
- Janë nënlokuar mjetet për mallra dhe shërbime për programe dhe nënprograme;
- Janë zotuar 190 lëndë për mallra dhe shërbime si shërbime komunale;
- Janë shpenzuar dhe certifikuar 170 lëndë;
- Aprovimi i kërkesave të institucioneve shkollore lidhur me shpenzimet nën 100 €;
- Mbajtja e evidencës së lëndëve të zotuar me modul blerjes, si dhe dorëzimi në prokurim.

3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Menaxhimi i kontratës “Furnizimi me inventar i çerdhes në lagjen “Kodra e Trimave”, përfshirë tërë inventarin e brendshëm, specifikat dhe paramasat e inventarit;
- Formimi i Asociacionit të drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Projekti “Furnizimi me tepih i çerdheve”;
- Furnizimi me inventar i institucioneve edukativo-arsimore;
- Përcjellja e shpenzimit të buxhetit sipas planifikimit;
- Transporti për nxënës dhe arsimtarë;
- Menaxhimi i kontratave për mallra dhe shërbime;
- Kontrollimi i shpenzimeve për të gjitha institucionet shkollore;

3.1.1. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

3.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, korrik 2018.

4. Buxheti i shpenzuar dhe alokuar 07-2018				
Kategoria Eko.	Alokim	Shpenzim	Zotim - Obligim	Mbetje -S=
Paga	1.536.090,87	1.536.090,87	-	0
Komunali	198.563,64	58.853,38	45.285,84	94.424,42
10-21 M.SH	692.382,22	484.666,81	94.764,90	112.950,51
Subvencione	89.625,00	70.480,00	2.500,00	16.645,00
Donacione	76.987,73	26.174,00	-	50.813,73
FB-21-Kapitale	1.131.570,00	351.818,16	267.972,70	511.779,14
FB-22-Kapitale				
Gjithsej:	3.725.219,46	2.528.083,22	410.523,44	786.612,80

4.1.1. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit gjatë muajit korrik, ka realizuar mbi 159 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara katër ditë në javë.

5. Takimet me institucione të tjera

Për periudhën e muajit korrik të vitit 2018, janë realizuar takime me:

- zyrtarët e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- koordinatorin e cilësisë në nivel vendit;
- përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik;
- përfaqësuesit e sindikatës SBASHK-së;
- përfaqësuesit e Akademisë së grave për lidërsip;
- përfaqësuesit e Zyrës së Kryeministrit;
- nënkryetarin e Komunës së Lipjanit;
- IFC- Banka Botërore;
- përfaqësuesit e KEDS;
- përfaqësuesit e MAPL-së;
- përfaqësuesit e PTT-së.

5.1.1. Diskutime publike/takimet me qytetarë

6. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare.

- Gjatë muajit korrik 2018, në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

6.1.1. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

- Gjatë muajit korrik 2018 janë pranuar gjithsej 79 lëndë, prej tyre të miratuara janë 8, të refuzuara 31 lëndë, të pezulluara 6 dhe në proces janë 34 lëndë.

7. Takime të tjera.

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takim me përfaqësues të prindërve të shkollave të caktuara;
- Takim me përfaqësues të këshillave drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takim me përfaqësuesit e komunitetit boshnjak.

8. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Riorganizimi dhe përcaktimi i përgjegjësive, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës të stafit edukativo-arsimor;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Kushtet jo optimale të punës për stafin e Drejtorisë së Arsimit, gjë që po reflekton drejtpërsëdrejti në cilësinë dhe realizimit të punëve dhe detyrave;
- Implementimi i Kurrikulës së re.

9. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë së Arsimit, në bazë të përgjegjësiave, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional, sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të komunës së Prishtinës;
- Përmirësimi i pozitës materiale të stafit profesional të Drejtorisë së Arsimit.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA;
- Kontrollim dhe monitorim i rregullt i institucioneve parashkollore, sipas dinamikës së planifikimit;
- Transferimi (migracioni) i brendshëm i personelit dhe i mësimdhënësve nga një shkollë në një shkollë tjetër dhe nga një vend pune në një tjetër, në bazë të nevojave dhe mundësiave;
- Sistemimi i mësimdhënësve nga një shkollë në shkollën tjetër, si rezultat i ndryshimeve kurrikulare;
- Krijimi i ekipit profesional në nivel të DA-së për monitorimin e përkrahjen e vlerësimit të performancës së shkollës;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Formimi i Asociacionit të drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Sigurimi i koordinatorit të cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për punë praktike;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe rrisitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Hartimi dhe zbatimi i planit për konsolidimin e shkollave;

- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Monitorimi i zbatimit të kurrikulës;
- Hartimi i kurrikulave të AAP-së;
- Krijimi i mekanizmave për nxitjen e përkrahjes dhe motivimit të mësimeve për zbatim të kurrikulës;
- Aftësimi dhe informimi i mësimeve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Kontraktimi i një kompanie nga Komuna për rregullimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-ut në shkolla;
- Hartohen pakot themelore dhe të specializuara të teknologji arsimore sipas prioriteteve dhe nivelit arsimor (0, 1, 2, 3), llojit të shkollimit (profesional – i përgjithshëm), drejtimit (shkenca, arte, matematikë, ...), profilit (varësisht nga profili i shkollës profesionale). Sigurohen pakot mësimore dhe bëhet shpërndarja e tyre në shkolla dhe institucione parashkollore;
- P.sh. School Me ose platforma online të të nxënësve (2018 – pilotim);
- Trajnimi i mësimeve;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Krijimi i mekanizmave brenda shkollave, të cilat do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këta donatorë;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Hartimi i rregullores që organizon (mbledhjen) ngritjen e kontributeve dhe donacioneve nga prindërit dhe komuniteti;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Aftësohet personeli për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB-së në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);

- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA-së për numër të fëmijëve në IP;
- Ekipi komunal harton planin e përmirësimit për tejkalimin e problemeve dhe avancimin e standardeve të IP-ve në komunë;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH;
- Trajnimi i mësimitdhënësve për shmangie të ndëshkimit fizik ndaj nxënësve;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimitdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrahë NNV-në dhe nxënësit me talente;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- Fillimi i implementimit të projektit “ Furnizimi me lloptë, projektorë dhe fotokopje të shkollave”;
- Fillimi i zbatimit të projektit “ Furnizimi i shkollave me rekuizita sportive”;
- Furnizimi i shkollave me pelet për nxemje;
- Furnizimi me libra për klasat I-IX;
- Furnizimi me material pedagogjik i institucioneve arsimore;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë.

11. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme